

## MENDIM PAKICE

1. Unë gjyqtare Manjola Xhaxho, duke qenë se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, në lidhje me vendimin nr. 16, datë 24.04.2023, paraqes argumentet e mëposhtme:

2. Në ndryshim nga shumica vlerësoj se pala paditëse legjitimohet në ngritjen e padisë në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor. Në rastin konkret pala paditëse, Partia Demokratike, është parti e regjistruar në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, pra është subjekt zgjedhor sipas kuptimit të nenit 2, pika 20 e Kodit Zgjedhor. Me padinë objekt gjykimi pala paditëse ka kundërshtuar vendimin nr. 60, datë 19.04.2023 të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS), si dhe vendimin nr. 366, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (Komisioneri) që kanë konkluduar se kandidati i njëjës prej partive politike dhe konkretisht Partisë Socialiste (PS) që garon në pozicionin e kryetarit të Bashkisë Mallakastër nuk ka ndalim ligjor për të marrë pjesë në zgjedhje në kuptim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” të ndryshuar (ligji nr. 138/2015). Konkretisht pala paditëse pretendon se kandidati i PS për kryetar i Bashkisë Mallakastër z. Qerim Ismailaj është deklaruar fajtor me vendimin gjyqësor nr.11, datë 02.02.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për veprën penale të falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve, parashikuar nga neni 190 paragrafi 1 i KPenal dhe është dënuar me 6 muaj burgim, i cili në aplikim të nenit 406 të KPrP është ulur me 1/3, në 4 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 63 të KPenal është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim duke u detyruar i dënuari me kryerjen e punës në interes publik pas shpërblim për një kohë prej 40 orësh që do të kryhet brenda afatit prej 6 muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte të rregullta me shërbimin e provës.

3. Sipas palës paditëse ky subjekt ka ndalim ligjor për t’u zgjedhur, duke qenë se sipas nenit 2, pika 1, gërma “ç”; nenit 4, pika 4 dhe pika 9 të ligjit nr. 138/2015 konsiderohet i dënuar me 6 muaj burgim dhe ka pengesë ligjore për t’u zgjedhur për 2 vite. Për pasojë, sipas palës paditëse Komisioneri dhe më tej KAS duhet të mos lejonin kandidatin e mësipërm të kandidonte për pozicionin e kryetarit të Bashkisë Mallakastër.

4. Sipas përfaqësuesve të palës së paditur, KQZ, subjekti nuk ka ndalim ligjor, pasi është dënuar me punë në interes publik, të cilën e ka kryer sipas vendimit datë 09.03.2023 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe për pasojë në bazë të nenit 63 të Kodit Penal konsiderohet i padënuar. Këtë qëndrim mbajti dhe personi i trete PS, i cili deklaroi gjithashtu se pala paditëse nuk legjitimohet të ngrëjë padinë.

5. Së pari në ndryshim nga shumica vlerësoj se pala paditëse legjitimohet në ngritjen e padisë dhe duhet të merreshin në shqyrtim pretendimet e saj në themel. Pala paditëse është subjekt zgjedhor dhe ka interes të ligjshëm të paraqes padi ku të ngrëjë pretendime në lidhje me

kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor që garon në zgjedhjet vendore përballë kandidatit të saj, kur bëhet fjalë për kritere ligjore ndaluese në lidhje me të drejtën për t'u zgjedhur. Kjo pasi kritere të tilla janë shkak për pavlefshmëri të procesit zgjedhor në zonën zgjedhore përkatëse. Pra, subjekti zgjedhor që merr pjesë në zgjedhje dhe ka përballë një kandidat të një subjekti zgjedhor që pretendon se nuk plotëson kriteret e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka të drejtë të kundërshtojë kandidimin e tij fillimisht në KQZ (siç ka ndodhur, pasi si Komisioneri ashtu dhe KAS kanë marrë në shqyrtim ankesën) dhe më pas kundër këtyre vendimeve të paraqes padi në Kolegjin Zgjedhor sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor që parashikon se *subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi.*

6. Kufizimet e të drejtës për t'u zgjedhur janë parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës ku thuhet se:

*1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.*

*2. Përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paafte mendërisht.*

*3. Përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.*

7. Pra, rregullimi i mësipërm parashikon kritere kushtetuese ndaluese të çdo individit për të ushtruar të drejtën kushtetuese për t'u zgjedhur. Këto kritere janë mosha, zotësia për të vepruar, si dhe dënimi me burgim. Ky ndalim i fundit i parashikuar në pikën e tretë të nenit 45 të Kushtetutës, është shtuar me ligjin për ndryshimin e Kushtetutës nr.137/2015, datë 17.12.2015. Në bazë të këtij rregullimi kushtetues është miratuar nga Kuvendi ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” që ka rregulluar në mënyrë më të detajuar këtë kufizim.

8. Këto kritere janë urdhëruese, në lidhje me ndalimin e të drejtën për t'u zgjedhur. Pra, kandidatët për kryetar bashkie që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 45 të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 138/2015 nuk gëzojnë të drejtë për t'u zgjedhur dhe për pasojë

kandidimi dhe përfshirja e tyre në zgjedhje do të ishte e paligjshme dhe antikushtetuese. Një shkelje e tillë, cënon rëndë procesin zgjedhor, që e bën atë të pavlefshëm sipas nenit 60 pika 1 gërma “a” e Kodit Zgjedhor që parashikon se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se: a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhor.

9. Për këtë shkak, Komisioneri ka të drejtën të kryejë edhe *ex officio* verifikimin e përputhshmërisë së kandidatëve për kryetar bashkie me kërkesat e ligjit nr. 138/2015 dhe të nenit 45 të Kushtetutës, në bazë të nenit 33 shkronja “f” e Kodit Zgjedhor dhe nenit 5 të ligjit nr. 138/2015. Kjo pasi nëse një kandidat ka ndalim ligjor për t’u zgjedhur nuk duhet të lejohet të marrë pjesë në zgjedhje, pasi cenon vlefshmërinë e procesit zgjedhor. Në këtë kuptim një vendim i Komisionerit dhe më pas i KAS-it në lidhje me lejimin apo ndalimin e një kandidati për të ushtruar të drejtën për t’u zgjedhur sipas kriterëve kushtetuese (neni 45 i Kushtetutës) dhe ligjore (ligji nr. 138/2015) është objekt ankimi në Kolegjin Zgjedhor, si nga subjektit që i është ndaluar kjo e drejtë (në rast ndalimi), ashtu dhe nga subjektet e tjera zgjedhore që kandidojnë përballë subjektit që pretendojnë se i duhet ndaluar kandidimi (në rast lejimi).

10. Në mbështetje të sa më sipër ankesat dhe pretendimet në lidhje me kriteret ndaluese të së drejtës së kandidatëve për t’u zgjedhur, duhet të shqyrtohen nga KQZ dhe më pas mbi ankimin e subjektit zgjedhor nga Kolegji, në çdo rast kur konstatohen, si para ashtu dhe pas ditës së zgjedhjeve. Pra, në këtë kuptim subjekti zgjedhor, pala paditëse ka interes, që procesi zgjedhor ku përfshihet kandidati i saj, të jetë i vlefshëm dhe mos të cënohet nga kriteret ndaluese ligjore që mund të ketë kandidati tjetër përballë të cilit konkuron. Pra, nuk bëhet fjalë për të drejtën e zgjedhësve për të zgjedhur një kandidat që ofron programe apo platforma politike të caktuara që mund të preferohen apo jo nga votuesit, por për të drejtën e kandidatëve (shtetasve) për t’u zgjedhur apo jo, e cila kufizohet me Kushtetutë dhe ligj. Në një rast të tillë, kandidati që ka ndalim nuk duhet të garojë në zgjedhje dhe nuk duhet të jetë i zgjedhur, pasi nuk gëzon të drejtën për t’u zgjedhur.

11. Në këto kushte, siç ka vepruar Komisioneri dhe KAS, Kolegji duhet të shqyrtojë pretendimin e palës paditëse nëse kandidati i PS për kryetar bashkie i Bashkisë Mallakastër z. Qerim Ismailaj kishte ndalim ligjor sipas ligjit nr. 138/2015 për t’u zgjedhur dhe për pasojë për të kandiduar për këtë pozicion.

12. Mos legjitimimi i palës paditëse çon në pamundësinë e shqyrtimit nga Kolegji të ligjit nr. 138/2015 gjatë procesit të verifikimit të kandidatëve nga Komisioneri, pra nëse vendim-marrja e Komisionerit është e bazuar në ligj apo jo, duke e lënë jashtë kompetencës së Kolegjit, shqyrtimin e ligjshmërisë së zbatimit të këtij ligji në këtë fazë të procesit zgjedhor dhe për pasojë të marrë në shqyrtim këto pretendime vetëm nëse ngrihen çështje të pavlefshmërisë së zgjedhjeve, duke

lejuar zhvillimin e zgjedhjeve potencialisht fiktive, në rast se provohet ky fakt. Ndërkohë që ligji nr. 138/2015 është miratuar pikërisht për të evituar situatën që në procesin zgjedhor të përfshihen persona që ky ligj ndalon.

13. Po ashtu vlerësoj të vë në dukje se moslegjitimimi i palës paditëse dhe rrëzimi i padisë, çon në lënien në fuqi të një vendim-marrje të shqyrtimit në themel të pretendimeve të palës paditëse nga KQZ (Komisioneri dhe KAS) në lidhje me shkaqet ndaluese sipas ligjit nr. 138/2015 të kandidatit për kryetar bashkie. Në këtë kuptim kjo vendim-marrje objekt gjykimi e Komisionerit dhe KAS përbëjnë gjë të gjykuar para tyre, nëse ngrihet i njëjti pretendim nga subjektet zgjedhore në kuadër të pavlefshmërisë të zgjedhjeve. Për pasojë ankimimi administrativ në këtë rast bëhet joefektiv.

14. Në këtë kuptim vlerësoj se padia duhej të shqyrtohej në themel dhe marrë në analizë nëse kandidati për kryetar bashkie të Bashkisë Mallakastër kishte apo jo ndalim ligjor në kuptim të ligjit nr. 138/2015.

15. Së dyti, sa i takon këtij pretendimi vlerësoj se KQZ ka zbatuar gabim ligjin nr. 135/2015. Konkretisht ligji nr. 138/2015 ka rregullime të tjera nga K.Penal në lidhje me çfarë konsiderohet i dënuar për efekt të zbatimit të këtij ligji në kuadër të kufizimit të të drejtës për t'u zgjedhur. Kjo nisur nga rëndësia që paraqet pozicioni i të zgjedhurit si përfaqësues i zgjedhësve. Ligji nr. 138/2015 lindi si domosdoshmëri dhe u miratua me qëllim që të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura, siç parashikon shprehimisht në nenin 1 të tij. Për pasojë ligji vë kufizime në lidhje me shtetasit që dëshirojnë të kandidojnë në zgjedhjet vendore dhe qëndrore, kur ata kryejnë vepra penale.

16. Konkretisht, për sa ka lidhje me çështjen objekt gjykimi, ligji nr. 138/2015, parashikon ndër të tjera në nenin 2, pika 1, gërma “ç” se nuk mund të kandidojnë për kryetar bashkie personat, të cilët janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me jo më pak se 6 muaj burgim për kryerjen e një krimi me dashje. Ndërkohë në nenin 4 të ligjit parashikohet koha e këtij ndalimi për këta persona për të ushtuar të drejtën për t'u zgjedhur, e cila në pikën 4 përcakton se për personat që konsiderohen të dënuar sipas nenit 2, pika 1, gërma “ç” e ligjit, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burgim sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë deri në momentin e rehabilitimit sipas nenit 69 të KPenal. Pra për periudhën e ndalimit, ligji referon në afate të njëjta me ato rehabilituese të Kodit Penal që sipas nenit 69, ky afat për dënimin deri në 6 muaj apo më të lehtë është 2 vjet. Pra, në rastin konkret për një shtetas që është dënuar jo më pak se 6 muaj burgim afati i ndalimit për të ushtuar të drejtën për t'u zgjedhur është 2 vjet.

17. Nga ana tjetër në pikën 9, të nenit 4 të ligjit nr. 138.2015 parashikohet se në masën e dënimit a) nuk do të përfshihet ndër të tjera ulja e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar apo pezullimi i dënimit me burgim, apo çdo shkurtrim i dënimit, si dhe b) këto shkurtime dënimi apo pezullime dënimi nuk ndikojnë në zbatimin e ligjit nr. 138.2015 dhe nuk llogariten në funksion

të shkurtimit të afatit të dënimit me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimit të parashikuar në këtë ligj.

18. Për pasojë në dënimin e kandidatit objekt gjykimi nuk llogaritet as ulja e përfituar nga gjykim i shkurtuar, as pezullimi i dënimit me burgim me qëllim dënimin alternativ të tij me punë në interes publik. Pra, dënimi për efekt të zbatimit të ligjit nr. 138/2015 llogaritet 6 muaj burgim, sipas paragrafit të parë të dispozitivit të vendimit gjyqësor, pa u zbatuar paragrafi i dytë i tij ulja e dënimit në 4 muaj burgim sipas nenit 403 të KPrC dhe më pas pezullimi i dënimit me burgim për efekt të dënimit alternativ me 40 orë punë në interes publik, sipas nenit 63 të KPenal. Pra, nuk konsiderohet pjesa e dënimit me 4 muaj burgim, i pezulluar me 40 orë punë në interes publik në pëllogaritjen e dënimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015.

19. Nëse do të përllogariteshin këto pjesë të vendim-marrjes së dënimit atëherë do të shkurtohej dhe koha e ndalimit apo më tepër se kaq, do të përjashtohej kandidati nga aplikim i ligjit nr. 138/2015. Neni 4, pika 9 e ligjit nr. 138/2015 është i qartë dhe nuk lë vend për interpretim në këtë drejtim. Kështu pretendimi i palës së paditur se tashmë është ekzekutuar vendimi gjyqësor, pasi është kryer puna në interes publik dhe për pasojë sipas nenit 63 të Kodit Penal kandidati nuk konsiderohet i dënuar është i pabazuar në ligjin nr. 138/2015. Vërtet që sipas nenit 63 të Kodit Penal personi që ka kryer punën në interes publik konsiderohet i padënuar, por kjo është e parëndësishme për efekt të zbatimit të ligjit nr. 138/2015. Sipas këtij ligji për efekt të aplikimit të tij, pezullimi i dënimit penal, siç është në rastin konkret, dënimi alternativ me punë në interes publik nuk gjen zbatim. Pra, ritheksoj se për efekt të ligjit nr. 138/2015 vendimi gjyqësor përcakton vetëm dënimin penal prej 6 muaj burgim. Për pasojë kandidati për kryetar bashkie të Bashkisë Mallakastër është dënuar për një krim me dashje, falsifikim të formularit, me 6 muaj burgim, dënim që është kryer, pasi ka përmbushur dënimin alternativ 40 orë punë në interes publik sipas vendimit datë 09.03.2023 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Për pasojë për 2 vjet, nga kjo datë kur është ekzekutuar vendimi penal ky kandidat nuk gëzon të drejtën për t'u zgjedhur në bazë të nenit 2, pika 1, gërma “ç”; nenit 4, pika 4 dhe 9 e ligjit nr. 138/2015. Për pasojë vendimet e Komisionerit dhe KAS duhet të shfuqizoheshin dhe të urdhërohej ndalimi i kandidatit z. Qerim Ismailaj të kandidonte në zgjedhjet vendore për kryetar bashkie të Bashkisë Mallakastër.

**GJYQTARE**

**Manjola XHAXHO**